



# Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), nenit 32 paragrafi 5 të Ligjit për transport rrugor Nr. 04/L-179 të datës 16.05.2013 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit të datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2015, miratoi këtë:

## R R E G U L L O R E

Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve 01 Nr. 811 të datës 28.03.2013

### Neni 1

Neni 8 paragrafi 1.7 i Rregullores bazë ndryshohet dhe do të jetë si vijon:  
Personat pas moshës 65 vjet për të fituar të drejtën e veprimtarisë së transportit taksi duhet të pajisen me certifikatën mjekësore jo më të vjetër se një (1) vit, me të cilën argumentohet aftësia psiko-fizike e personit për ushtrimin e këtij aktiviteti.

### Neni 2


Neni 37 i Rregullores bazë ndryshohet dhe do të jetë si vijon: "Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e komunës".

### Neni 3

Pas miratimit të kësaj Rregullore duhet të bëhet hartimi i tekstit të spastruar të Rregullores aktuale në fuqi.

01 Nr. 3089  
Rahovec, 31.08.2015

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani